

# BASHKËPËRKIMI I RASAVE NË GJUHËT BALLKANIKE

Naile MALA-IMAMI<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Fakulteti Filologjik në Beograd

<sup>2</sup>nailje.malja.imami@fil.bg.ac.rs

---

## Përmbledhje

Bashkëpërkimi formal midis rasave gjinore e dhanore në gjuhët ballkanike, të cilat kanë edhe mjaft bashkëpërkime të tjera midis tyre, është trajtuar si një ndër ballkanizmat kryesorë. Për këtë dukuri janë paraqitur hipoteza të ndryshme, dhe ndër më të përhapurat kanë qenë ato që e shihnin shfaqjen e kësaj dukurie në ndikimin e substratit të vjetër ballkanik, por edhe në ndikimin e greqishtes a të latinishtes, apo edhe si një dukuri që, të paktën, në disa nga gjuhët ballkanike duhet konsideruar si një zhvillim të brendshëm e të pavarur. Në do të merremi me bashkëpërkimin e rasës gjinore dhe dhanore, dukuri e cila është e pranishme në gjuhën shqipe, rumune, bullgare, maqedonase dhe në greqisht brenda arealit gjuhësor ballkanik, por me theks të veçantë në gjuhën shqipe. Do të argumentojmë se a është shkrirë dhanorja në gjinore siç është rasti i gjinore > dhanores në rumanisht dhe në shqip, ose e kundërta gjë që ka ndodhur me greqishten. Do të merremi edhe me përdorimin e frazës *-na* për të shprehur gjinoren e bullgarishtes dhe të maqedonishtes.

**Fjalë kyçe:** bashkëpërkimi i rasave, gjinorja, dhanorja, gjuhët ballkanike, shqipja, greqishtja, rumanishtja

---

## 1. Hyrje

Qysh nga Mikloshiqi e këtej është vënë në dukje se në gjuhët ballkanike është përftuar, ku më herët e ku më vonë, bashkëpërkimi formal i rasave gjinore e dhanore. Një dukuri e tillë, e cila nuk është e panjohur edhe në ndonjë gjuhë tjetër jashtë Ballkanit, del si e papritur sidomos për gjuhët, që e kanë ruajtur pak a shumë mirë sistemin e lakimit, sepse rasat gjinore e dhanore, për nga funksionet, dallohen shkoqur njëra nga tjetra. Siç dihet, rasa gjinore ka shërbyer kryesisht për të shprehur përcaktorin e emrit, kurse dhanorja ka shërbyer kryesisht për të shprehur kundrinën e zhdrejtë, pra, për të plotësuar foljen-kallëzues. Duhet pasur parasysh se edhe për nga mbaresat këto dy rasa në përgjithësi kanë qenë të dalluara nga njëra-tjetra. Këtë dukuri disa gjuhëtarë e kanë parë si një nga shfaqjet e ndikimit të substratit të vjetër. Disa të tjerë si edhe ballkanizmat e tjerë që dalin edhe në greqishte, burimin e saj e kanë kërkuar pikërisht në këtë gjuhë të vjetër kulturore të Ballkanit. Kurse disa të tjerë kanë vënë në dukje ndikimin e latinishtes<sup>431</sup> (Demiraj, 2004: 69).

Gjuhëtari kroat Milivoj Shrepel në vitin 1890 e përkufizoi se bashkëpërkimi i rasave krijohet kur dy forma të rasave i zëvendësojnë funksionet e veta, dhe më pas një kohë i përdorin të dy format për të njëjtin funksion, derisa më në fund të mbizotërojë njëra formë. "Pra kjo formë, krahas sferës së vet, e ka pasur edhe sferën e dukshme të formës së vet të zhdukur.

---

<sup>431</sup> Po aty.

Kjo mund të krijohet në dy raste: Kur forma e një rase, duke ia besuar funksionin e vet formës tjetër të rasës, ajo zhduket krejtësisht; psh., instrumentalin e latinishtes, gjurmët e të cilit gjenden vetëm te disa ndajfolje, ose dy rase i bashkojnë funksionet, kështu që te disa fjalë mbizotëron njëra formë, kurse te fjalët e tjera një formë tjetër, psh., në gjuhën greke dhanorja dhe vendorja ë...] Shkaqet e bashkëpërkimit janë të ndryshme: Bashkëpërkimi mund të krijohet, nëse rasat në formën e jashtme bashkohen, psh., në latinisht gjinorja dhe vendorja, në greqisht është vetëm një shembull: dhanorja dhe vendorja; por edhe më e zakonshme është, kur funksionet e dy rasave barazohen, psh., në greqisht dhanorja dhe instrumentali, kur instrumentali e nënkupton personin, i cili e kryen veprimin. Kështu, në gjuhët sllave, gjinorja është sinkretike, është krijuar nga gjinorja dhe rrjedhorja, si edhe gjinorja e greqishtes." (1890: 3).

Çabej thekson se në gjuhët indoevropiane në të cilat janë zhdukur disa rase, kjo ka ndodhur në një periudhë shumë të hershme. Në greqishten e lashtë, hitishten dhe gjuhët e lashta indiane, gjinia asnjansë e emërores, kallëzores dhe thirrores i kanë format e njëjta. Gjithashtu, një numër i madh i emrave të gjinisë mashkullore në thirrore dhe në emërore e kanë formën e njëjtë. Kjo dukuri, barazimi i rasave, kur një rasë shkrihet, përkatësisht e rimerr formën e rasës tjetër, emërtohet sinkretizëm ose bashkëpërkim. Është interesant, se ky term është krijuar sipas ishullit grek Kretë, kur bashkohet me parashtesën "sin" /bashkë, së bashku/: sin+Kreta+izëm, sepse në të këtë ishull "janë shkrire" popujt e ndryshëm që kanë jetuar në të. (1986: 96)

Bashkëpërkimin e gjinore dhe dhanore e ka rumanishtja, shqipja, bullgarishtja, maqedonishtja dhe greqishtja.

Për origjinën e bashkëpërkimit të gjinore-dhanore Catasso i thekson tri hipoteza: (1) hipoteza e parë është se kjo dukuri e ka origjinën romake dhe se është përhapur në mënyrë suksesive në arealin ballkanik, përmes rumanishtes, sepse forma e njëjtë është përcaktuar për gjinoren dhe dhanoren për emrat e gjinisë femërore në njëjës të Lakimit të parë në latinishten klasike (*rosae* /trëndafili/ - GJEN/DHAN'). Për këtë dëshmojnë edhe mbishkrimet e shumta të latinishtes vulgare të gjetura në Dalmaci dhe në rajonin danubian (p.sh., me PD *filius regi* vs. *filius regis*); (2) hipoteza e dytë përkon me propozimin e Banfit (1985:53) se kjo dukuri ndoshta mund ta ketë origjinën në gjuhën bullgare ose maqedonase, gjuhë pa rase, që shprehet me ndihmën e së ashtuquajturës frazës ose përemrit *-na*; (3) hipoteza se origjina e bashkimit të dhanore dhe gjinore mund të gjendet në greqisht "diku në fillim të shekujve të parë të erës sonë", siç thekson (Sandfeld, 1930: 186), si mjet për të thjeshtuar sistemin e formave flektive.<sup>432</sup> (2011: 74).

## 1.2. Bashkëpërkimi i gjinore-dhanore në gjuhën greke

Pasi e mbështeti mendimin që prania e një forme të përbashkët rase për gjinore-dhanoren në greqishte dëshmohej qysh në shekujt e parë të erës sonë, Sandfeldi vuri në dukje këtë dukuri të ngjashme edhe në gjuhët e tjera ballkanike dhe u ndal pak më shumë në ndërtimet e bullgarishtes, duke pranuar që në bullgarishten e vjetër ndeshen shembuj të shumtë përdorimi të dhanore në vend të gjinore. Dhe lidhur me këtë pohon: "Kjo nuk pengon të supozohet një lidhje midis këtyre gjuhëve në këtë pikë", Por, vetëm pasi e pranon edhe mendimin e M., Roque-ut, e të P. Skokut etj. Për përhapjen e kësaj dukurie edhe në latinishten vulgare, ai përfundon: "Pra, ka mundësi që të kemi të bëjmë me dy korrente homogjene, që kanë kontribuar të dy për uniformimin, që paraqisnin gjuhët ballkanike në këtë pikë".

---

<sup>432</sup> Po aty.

Por po të kemi parasysh qëndrimin e përgjithshëm të Sandfeldit për ndikimin e madh të greqishtes mbi gjuhët ballkanike, atëherë mund të pohohet se, sipas tij, njëri nga dy korrentet, që kanë ndikuar në përhapjen e dukurisë në shqyrtim në gjuhët ballkanike ka qenë ai i greqishtes. Por në këtë rast një ndikim grek ai duhet ta ketë supozuar vetëm për bullgarishten dhe shqipen. Supozimi për një ndikim grek në njësimin e formave të gjinore e të dhanore në gjuhët ballkanike në përgjithësi nuk ka gjetur përkrahje; megjithatë, nuk duhet hedhur poshtë patjetër për bullgarishten e maqedonishten.

Në gjuhën greke qysh nga shekujt e parë të erës sonë përdorimi i formës së gjinore edhe me vlerën e dhanore ka qenë diçka që bie në sy<sup>433</sup>. Por në greqishten e re kuptimi i rasës dhanore shprehet edhe nëpërmjet rasës kallëzore të prirë nga parafrasa s(eis). “në, mbi etj.”. P.sh. *To eipa s' ton patera mou* ëla thashë babait tim]. Në këtë rast kemi të bëjmë me një “evolucion të ri”, që nuk e ka nxjerrë jashtë përdorimit ndërtimin *To eipa tou patera mou*<sup>434</sup>, d.m.th., ndërtimin ku forma e gjinore është përdorur me vlerën e dhanore. (Demiraj, 2004: 76, 70).

Asenova thekson edhe se në greqisht gjinorja, si zëvendësim për dhanoren e cila u ruajt një kohë të gjatë për kundrinën e zhdrejtë, paraqitet në periudhën e varietetit grek mbidialektor *koine*. Dëshmitë më të hershme ekzistojnë nga shek. I, para erës së re, te përemrat vetorë, psh.: *δώσω σου / të jap ty/* (viti 46, para erës së re). Dalja përfundimtare nga përdorimi i gjallë i formave të dhanore, gjë që shihet edhe në testet e shkruara, ka të bëjë me periudhën e Mesjetës (shek. 6-7). (Asenova, 2002: 84).

Më tutje, Asenova thekson se si pasojë e drejtpërdrejtë e njësimin të gjinore dhe dhanore paraqitet përdorimi i trajtave të shkurtra të dhanore (*në greqisht të gjinore*) së përemrave vetorë dhe vetvetorë në shërbim të përemrave pronorë. Që në greqishten e lashtë klasike një nga mënyrat për të shprehur përkatësinë ka qenë përemri vetor në gjinore: *ὁ πατήρ μου* (sot, *ἡμών, ὑμών*)/ ose *μου* (sot, *ἡμών, ὑμών*) *ὁ πατήρ*. Në greqishten e re, në funksion pronësor zakonisht përdoren në njëjës format e gjinore, kurse në shumës, format e kallëzore së përemrave vetorë: *ἡ μητέρα μου* `nëna ime`, *ὁ πατέρας σου* `babai ty`, *ἡ κόρη του* `e bija e tij`, *το βραχιόλι της* `byzyluku i saj`, *ἡ πατρίδα μας* `atdheu ynë`, *το κόμμα σας* `partia jonë` etj. Asenova theksoi se në historinë e gjuhës greke dhanorja zëvendësohet si me gjinoren, ashtu edhe me kallëzoren). Forma *τους* për të tri gjinitë në shumës me siguri u krijua si formë e gjinore në shumës *του* për njëjës me shtesën */-ς/* si mbaresë për shumës<sup>435</sup>.

Asenova këtë bashkëpërkim e shpjegon me afërsinë e kuptimit të atributitetit dhe posesivitetit dhe vlerëson se në sintaksën e greqishtes gjinorja i ka pranuar edhe funksionet e dhanore: *Τα βιβλία της Ελένης*. ëLibrat për helenët]; *Γυναίκα, της ψυχής μου ζένη* ëΓ. Σεφέρης. ëGruaje – ana e shpirtit tim.] Prandaj bashkëpërkimi formal midis rasave gjinore e dhanore në gjuhët ballkanike, të cilat kanë edhe mjaft bashkëpërkime të tjera midis tyre, është trajtuar si një ndër ballkanizmat kryesorë; Asenova shton se dhanorja dhe gjinorja e greqishtes mund të shpjegohet me afërsinë e

<sup>433</sup> Sandfeld, K: (1930), 186: “Pra, ekzistenca e një gjinore - dhanoreje në greqishte është një fakt i vërtetuar, që shkon deri në shekujt e parë të erës sonë (shih Dieterich. Untersuchungen, f. 149 v.)”.

<sup>434</sup> Demiraj, Sh: (1986), 283 v.

<sup>435</sup> Po aty.

### 1.3. Bashkëpërkimi i gjinore-dhanores në gjuhën rumune

Bashkimi i dhanores dhe gjinores në rumanisht ndoshta përfaqëson fazën e kristalizimit ose, siç përfundojnë disa gjuhëtarë, "një fazë vjetrimi" të sistemit latin të rasave. Aq më parë, dhanorja e latinishtes shpesh është përdorur për të shprehur përkatësinë, pa e marrë parasysh thjeshtësimin e formave flektive, sidomos kur shënohet posesiviteti i patjetërsueshëm (emrat, anëtarët e familjes, pjesët e trupit, etj.), gjë që duket se sugjeron se karakteri dhënës i dhanores është i lidhur me këtë lloj të marrëdhënies kuptimore, si për shembull p.sh.: *Mihi est pecunia. Mihi est filius. ëUnë kam të holla. Ai është djali im.*] (Catasso, 2011: 74)

Edhe në rumanishte bashkëpërkimi i rasave gjinore e dhanore paraqet disa veçori të ngjashme me ato të shqipes. Por në këtë rast ka edhe ndonjë ndryshim jo të parëndësishëm midis këtyre dy gjuhëve. Në rumanisht rase gjinore dallohet nga dhanorja nëpërmjet së ashtuquajturës nyjë e përparme *al (a, ai, ale)*<sup>436</sup> Por, ndryshe nga ç'ndodh në gjuhën shqipe, paranyjëzimi i rasës gjinore në rumanishte bëhet vetëm kur ajo vjen pas një emri të pashquar. P.sh. të krahasohen: *o casj a vecinului* ënjë shtëpi e fqinjit] ~*casa vecinului* ështëëpia e fqinjit]. Nyja e përparme e rasës gjinore në rumanishte nuk është shumë e vjetër, ajo duhet të jetë përfutur midis shekujve XII-XIV<sup>437</sup>. Prandaj mund të pohohet se në rumanishte paranyjëzimi i rasës gjinore është përfutur pas njësisimit të kësaj rase me dhanoren dhe është pasojë e jo shkak i këtij njësimi. Njësimi formal i rasave gjinore e dhanore ka nisur qysh në periudhën e latinishtes danubiane<sup>438</sup> (Demiraj, 2004: 74).

Tabela 1: Analiza e përdorimit sintaksor të gjinores dhe dhanores:

	GENITIV	DATIV
Rumanisht	<i>casa bătrânul-ui</i>	<i>are spus acesta bătrânul-ui</i>
Shqip	<i>shtëpia e plak-ut</i>	<i>i tha plak-ut</i>
Bullgarisht	<i>kăštata na starikăt</i>	<i>(mu) reče na starikăt</i>
Greqisht	<i>to spiti tu anthrop-u</i>	<i>tou spiti tou anthropou/ston anthropo</i>

### 1.4. Bashkëpërkimi i gjinore-dhanores në bullgarisht

Në bullgarisht, në vend të kësaj, gjinorja dhe dhanorja shprehen përmes të së ashtuquajturës frazës *-na*, përkatësisht me përdorimin e parafjalës *-na*. (Catasso, 2011:73).

Te bashkëpërkimi i gjinores dhe dhanores në gjuhën bullgare dhe rumune interpretues formal i funksioneve të të dy rasave u bë dhanorja:

- rum. *Lumina stinsului amor/Ne urmărește încă.* (M. Eminescu) ' Drita e shuar e dashurisë / Na ndjek akoma ' Jep horizont pa kufi / Vetminë e detit. (M. Eminescu).

Në sintaksën e gjuhës bullgare kjo shkrimje vërehet te të shprehurit e marrëdhënieve të vjetra me dhanore dhe gjinore me një parafjalë të vetme - na: *Лудорите на сина му го бяха накарали да си развали навиците.* /Çmenduritë e birit të tij e detyruan që t'i ndryshojë shprehitë e veta (J.Јовков); *Знайт ли кой е тоја - заговори гордо и тържествено Киро на другарите си.* (J.Јовков) /A mos e dini kush është ai – filloi Kiro t'u flasë me krenari dhe solemnisht shokëve të tij/. (Asenova, 2002: 84).

<sup>436</sup> Trajta e gjinores shumë *alor* përdoret vetëm me përemrat pronorë; shih GLR I, 105

<sup>437</sup> Mirçev,K: (1950),125,133; Koneski: 1967/1, 159 v.

<sup>438</sup> ILR II, 220; Coteanu: 1969,58.

Edhe në shqip format e kësaj rase nuk dallohen: *Dhimovica bënte ç' bënte dhe i thoshte Kolit*. (Th. Kacori) /;: ... *kishte dhënë shpirt me emrin e Minait në gojë*. (Th. Kacori) Shikuar historikisht, mbaresat e njëjësit bashkohen me mbaresat e vjetra për dhanore, kurse në shumës mbaresa *-e* (sot *ve*) – me mbaresën e vjetër për dhanore. (Demiraj 1972:65).

Dominimi i dhanores ndaj gjinores në bullgarisht shprehet me parafjalët *-na* i *-ot* me rastin e shprehjes së posedimit, me të cilin rast mbizotëron parafjala *-na*, kurse *-ot* përdoret për të shprehur marrëdhëniet partitive. Për këto shkaqe në një marrëdhënie të ngjashme përdoren parafjalët *-a* i *-de* në rumanisht. Përndryshe, në gjuhën bullgare parafjala e hershme dhanore *-na* është përdorur për ta shprehur gjinoren<sup>439</sup>.

Për sa i takon bullgarishtes dhe maqedonishtes, ku sistemi i lakimit duhet të jetë mënjanoar aty nga shekujt XII-XIV<sup>440</sup>, për rastin në shqyrtim nuk është fjala për njësimin e formave rasore sintetike të gjinores e të dhanores. Këtu është fjala për shtrirjen e formës së ngurosur emërore të prirë nga parafjala *-na* “mbi, në, për” me vlerën e rasës dhanore edhe në funksionin e rasës gjinore. P.sh. të krahasohen: (bullg.) *knigata na učenikot* ëlibri i nxënësit] dhe (*mu*) *reçe na učenikot* ëi tha nxënësit]. Përdorimi i parafjalës *-na* për të shprehur kuptimin e rasës dhanore në bullgarisht nuk është i vjetër. Sipas Mirçevit(1950, 139), parafjala *-na* para një emri me vlerën e dhanores nuk del gjëkund në dokumentet e bullgarishtes së mesme (shekujt XII-XIV). Prandaj forma e sotme e dhanores me parafjalën *-na*, me sa duket, është shfaqur jo më herët se shekulli XV. Në këto rrethana, duhet pranuar që shtrirja e përdorimit të kësaj forme analitike edhe me vlerën e rasës gjinore duhet të jetë përfutur pas shekullit XV<sup>441</sup>. (Demiraj, 2004: 74).

Edhe Catasso konstaton se përdorimi i parafjalës *-na* për të treguar kuptimin e dhanores në bullgarisht nuk është i vjetër. Sipas tij, parafjala *-na* para emrit në rasën dhanore nuk del askund në dokumentet e bullgarishtes së mesme (shek. XII-XIV). Prandaj, trajta e sotme dhanore me parafjalën *-na* nuk duket të jetë shfaqur para shekullit XV, por më vonë. (Catasso, 2011: 74)

Lidhur me çështjen në shqyrtim duhet përmendur këtu se në shumicën e gjuhëve ballkanike ndeshet edhe një rast tjetër përdorimi i rasës dhanore me vlerën e gjinores. Është fjala për përdorimin e trajtës së patheksuar të dhanores të përemrave vetorë me vlerën e një gjinoreje të pronësisë, pra të një përemri pronor enklitik. Një përdorim i tillë, që në ndonjë gjuhë është përfutur vetëm pas emrash të farefisit, ndeshet në greqishte, në bullgarishtes-maqedonishte dhe në rumanishte.

P.sh.: *Greqisht: o patùras mou* ëbabai im], i (η) *manna sou* ënëna jote], to spiti *tu* ështëëpia e tij], ta ped(h) ia *mas* ëfëmijët tanë]<sup>442</sup> etj.

*Bullgarisht: polo*<sup>1/2</sup>*eneto mi* ëgjendja, pozita ime], uspehët *mu* ësuksesi i tij], rabotata *im* ëpuna e tyre] etj.

*Maqedonisht: tatko mi* ëati im], brat *vi* ëvëllai juaj], sestra *im* ëmotra e tyre].<sup>443</sup>

*Rumanisht: sufletu-mi* ëshpirti im], fiii-œi ëbijtë e tu], *moartea-i* ëvdekja e tij]<sup>444</sup> etj. (Demiraj, 2004: 74)

<sup>439</sup> Po aty.

<sup>440</sup> Mirçev, K: (1950),125,133; Koneski: 1967/1, 159 v

<sup>441</sup> Sipas Mirçevit: (1950),132 v., në një periudhë të mëparshme, kur u shfaqën shenjat e analizimit, me rasën gjinore përdorej parafjala *ot* “prej, nga”. Por, sipas Koneskit: 1969/1,166, ndërtime me parafjalën *na*, që mund të interpretohen me kuptim posesiv, ndeshen qysh në shekullin XIII.

<sup>442</sup> Shih Stojanov: (1977),291.

<sup>443</sup> Shih Koneski: (1967)/2,336, ku pohohet se këto trajta përemërore përdoren me emra farefisi.

<sup>444</sup> Shih GLR I,141.

Tabela 2: Shembujt e fjalive të bashkëpërkimit të gjinore dhe dhanore në gjuhën shqipe, arumune, bullgare, rumune, maqedonase dhe greke në krahasim me gjuhën serbe

Gjuha	Dhanorja	Gjinorja
Serbisht	<i>Dao sam knjigu <b>Mariji</b>.</i>	<i>Ky është libri i <b>Marisë</b></i>
Shqip	<i>Librin ia dhashë <b>Marisë</b>.</i>	<i>Libri është i <b>Marisë</b>.</i>
Arumanisht	<i>Vivlia lju dedu ali <b>Marië</b>.</i>	<i>Vivlia easti ali <b>Marië</b>.</i>
Bullgarisht	Дадох книгата <b>на Марија</b> ëdadoh knjigata <b>na Marija</b> ]	Книгата е <b>на Марија</b> ëknigata e <b>na Marija</b> ]
Rumanisht	<i>I-am dat cartea <b>Mariei</b>.</i> <i>I-am dat cartea <b>lui Marian</b>.</i>	<i>Este cartea <b>Mariei</b>. Este cartea <b>lui Marian</b>.</i>
Maqedonisht	Ќ ја дадов книгата <b>на Марија</b> . ëì ja dadov knjigata <b>na Marija</b> ]	Книгата е <b>на Марија</b> . ëknigata e <b>na Marija</b> ]
Greqisht	Έδωσα το βιβλίο <b>στην Μαρία</b> . ëédhosa to vivlío <b>stin María</b> ] ili Έδωσα το βιβλίο <b>της Μαρίας</b> . ëédhosato to vivlío <b>tis Marías</b> ]	Είναι το βιβλίο <b>της Μαρίας</b> . ëíne to vivlío <b>tis Marías</b> ]
	<b>Της</b> το έδωσα <b>ëtis</b> to édhosa]	Είναι το βιβλίο <b>της</b> . ëíne to vivlío <b>tis</b> ]

Marrë nga interneti: [http://en.wikipedia.org/wiki/Balkan\\_sprachbund](http://en.wikipedia.org/wiki/Balkan_sprachbund) (15.08.2022)

## 1.5 Bashkëpërkimi i gjinore-dhanores në gjuhën shqipe

Në gjuhën shqipe me sinkretizëm janë përfshirë gjinorja me dhanoren e më vonë këtyre u është bashkuar edhe rrjedhorja dhe kallëzorja e pashquar me emëroren. Në këtë pikëpamje shqipja ka reduktuar numrin e rasave dhe, si edhe gjuhë të tjera të kësaj familjeje, e ka thjeshtuar sistemin rasor të trashëguar. Krahas pakësimit të numrit të rasave me anë të sinkretizmit të tyre, ka ndodhur procesi i kundërt, numri i formave rasore është shtuar me krijimin e nyjave, që i kanë dyfishuar paradigmat e lakimit në të pashquar e të shquar. Numri i formave rasore nuk është i barabartë si për njëjës, ashtu edhe për shumës.

Në njëjës është ruajtur dallimi formal i formave rasore sipas gjinive; kurse në shumës ka vepruar sinkretizmi duke krijuar mbaresa të përbashkëta për të gjitha gjinitë; Bashkëpërkimi nuk është kurdoherë i njëjtë si për trajtën e pashquar, ashtu edhe për të shquarën. Kështu p.sh., bashkëpërkimi i emërores dhe kallëzores ka prekur trajtën e pashquar dhe të dyja trajtat e shumës të shquar, por ka lënë të paprekur të shquarën e njëjësit. Edhe sinkretizmi i rrjedhores me gjinoren e dhanoren ka prekur njëjës, por jo edhe shumës. Funksionet kryesore të rasave shqipja i ka ruajtur, por shpeshherë ato kanë kaluar prej njëres rasë tek tjetra. Në zhvillimin e saj të brendshëm shqipja ka krijuar edhe funksione të tjera të formave rasore. (Topalli, 2009: 50-51) (Vokri, 2017, 373)

Demiraj shton se procesi i njësimi të rasave gjinore e dhanore, në zanafillë, duhet të ketë marrë shkas nga faktorë të karakterit fonetik: Siç dihet, mbaresat rasore, sidomos pas ngulitjes së theksit zakonisht mbi një rrokje fundore, duke u ndodhur në pozicion jashtë theksit, kanë pësuar reduktime të shkallëshkallshme, që në disa raste kanë sjellë si pasojë edhe rënien e tyre të plotë. Pas të gjitha gjasave, shtrirja e mbaresës së dhanores njëjës edhe në rasën gjinore është vërtetuar në një kohë, kur kjo e fundit e kishte humbur mbaresën e vet. Shtrirja e mbaresës së ruajtur të dhanores edhe në gjinore do të jetë mundësuar edhe nga nevoja për të dalluar formalisht këtë rasë nga emërorja e kallëzorja (e pashquar) të mbetura, gjithashtu, pa mbaresa rasore.<sup>445</sup> (1986, 257)

Ndryshe nga Shaban Demiraj, Selman Riza thekson se dhanorja në njëjës “përkon fonetiki” me gjinoren përkatëse”, gjë që ndikoi në zhvillimin e mëvonshëm të gjuhës shqipe në bashkimin morfemik të dhanores njëjës me gjinoren (pa nyjë), e pastaj edhe gjinorja në shumës (pa nyjë) ka filluar të përdoret si dhanore; tërë kjo ndikoi që edhe mbaresa *-sh* e dhanore-rrjedhores në shumës ka filluar të përdoret vetëm si rrjedhore (1965: 28).

Përndryshe, tendenca për shkrirjen e gjinores dhe dhanores në një rasë është çështje e hapur në gramatologjinë e gjuhës shqipe. Funkzioni i rasës gjinore është i qartë: është rasë e përkatësisë. Sipas formës, gjinorja dallohet nga dhanorja vetëm sipas nyjës së përparme, e cila, sipas mendimit të Fatmir Agalliut, është një mjet i jashtëm analitik. Sipas tij, më e saktë do të ishte të flitej për dhanoren e cila përmbush funksionet e gjinores kur merr një nyjë të përparme, pra, për rasën dhanoren me formë të emëruar e cila funksionon si gjinore. Përafërsisht si në gjuhën rumune, me ndryshimin që nyja e përparme paraqitet vetëm kur emri i përcaktuar nuk ka nyjë të përparme ose kur midis saj dhe emrit në gjinore-dhanore hyn ndonjë fjalë e re (1980: 163). Në këtë pikëpamje shqipja ka reduktuar numrin e rasave dhe, si edhe gjuhë të tjera të kësaj familjeje, e ka thjeshtuar sistemin rasor të trashëguar; Krahas pakësimit të numrit të rasave me anë të bashkëpërkimit të tyre, ka ndodhur procesi i kundërt, numri i formave rasore është shtuar me krijimin e nyjave, që i kanë dyfishuar paradigmat e lakimit në të pashquar e të shquar. Edhe

<sup>445</sup> Por për Rizën, Emrat, 120, në numrin njëjës, (ka mjaft të ngjarë që në shqipe gjinorja dhe dhanorja të kenë koniciduar fonetiki njëra me tjetrën e për pasojë që këtu të përjashtohet hipoteza e përfshirjes së funksioneve të njëres rasë nga tjetra, konkretisht të gjinores nga dhanorja...”. Por për numrin shumës ai e pranon që gjinorja “qe ajo që dha dhanoren përkatëse e jo anasjelltas”.

në këtë drejtim shqipja ka ecur përkrah disa gjuhëve të tjera, që kanë krijuar një sistem të tillë rasor me anë të nyjave të prapme (sidomos rumanishtes); (Vokri, 2017: 371).

## PËRFUNDIME

Kjo dukuri në thelb i ka tri prirje: derisa rumanishtja dhe shqipja mund të thuhet se e kanë përthithur gjinoren ose, siç thekson Emanuel Banfi (1985: 52), prapashtesat e trashëguara për dhanoren përdoren për ta shprehur gjinoren<sup>446</sup>, e kundërta gjë vlen për greqishten, ku gjinorja përdoret për të shprehur rasën dhanore (p.sh. në gjinoren e veçimit). Në gjuhën bullgare, në vend të kësaj, gjinore-dhanorja shprehet përmes së ashtuquajturës frazës -na, përkatësisht me përdorimin e parafjalës -na. Nga gjuhët e Ballkanit këtu vjen në vështrim në radhë të parë rumanishtja, ku ka ndodhur i njëjti proces si në gjuhën shqipe, d.m.th., në njëjës ka mbijetuar forma e dhanores dhe në shumës ajo e gjinores<sup>447</sup>. Gjithashtu edhe në greqishten e re forma e rasës gjinore, si në njëjës edhe në shumës, është shtrirë edhe në dhanore<sup>448</sup>.

## Referencat:

- 1]. Agalliu, F. (1980). Sa rasa ka gjuha shqipe? /Koliko padeža ima albanski jezik?/. *Studime filologjike*, 1980, 3. s. 159-170. (prestampo: *Çështje të morfologjisë sëgjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, pp. 114-127)
- 2]. Asenova, P. (2002). *Balkanska lingvistika : Osnovni problem na balkanskij jezikov sajuz*, V. T'rnovo : Faber.
- 3]. Banfi, E. (1985). *Linguistica balcanica*. Bologna : Zanichelli.
- 4]. Catasso, N. (2011). *Genitive-Dative Syncretism in the Balkan Sprachbund: An Invitation to Discussion*. (Preuzeto sa interneta: [http://www.skase.sk/Volumes/JTL19/pdf\\_doc/04.pdf](http://www.skase.sk/Volumes/JTL19/pdf_doc/04.pdf) (15.06.2022))
- 5]. Çabej, E. (1986). Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane /Uvod u uporedne studije indoevropskih jezika/. *Studime gjuhësore, VII*. Prishtinë: Rilindja. s. 7-147.
- 6]. Demiraj, Sh. (1986). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe /Istorijska gramatikaalbanskog jezika*. Tiranë : 8 Nëntori.
- 7]. Demiraj, Sh. (2004). *Gjuhësi ballkanike /Balkanska lingvistika*. Tiranë : Shkenca (Preuzeto sa interneta: <http://dielli.net/pdf/historia/GjuhësiBallkanike.pdf> 15.06.2012)
- 8]. Demiraj: (1972) Demiraj, Shaban. *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*. Tiranë
- 9]. Malja-Imami, N. (2012). *Konvergencija i divergencija padežnih sistema*. Beograd: Filološki fakultet. (Preuzeto sa interneta: [konvergencija i divergencija padežnih sistema \(bg.ac.rs\)](http://konvergencija.i.divergencija.padežnih.sistema.bg.ac.rs))
- 10]. Mirčev, Kiril (1950), *Istoričeska gramatika na bālgarskii ezik*. Sofija : Nauka i izkustvo
- 11]. Riza, S: (1965). *Emrat në shqipe : sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit /Imenice u albanskom jeziku : padežni sistem i tipovi deklinacija*. Tiranë : Universiteti Shtetor iTiranës.
- 12]. Sandfeld, Kr. (1930), *Linguistique balkanique : Problèmes et résultats*. Paris : É. Champion Sandfeld, Kr. – P. Skok (1936), “Balkanski jezici”. *Knjiga o Balkanu*, I. Beograd : Izdanje Balkanskoga instituta, s. 260-267.
- 13]. Šrepeš, M. (1890). Analogija u sintaksi gramatičnih padeža latinskoga i hrvatskoga jezika. *Rad Jugoslavenske akademije znanosti i umjetnosti*. Razredi filologičko- historički i filosofočko-juridički. Zagreb, knj. 31, str. 1-29. (Preuzeto sa interneta: <http://www.archive.org/stream/radjugoslavensk08umjegoog/radjugoslavensk08umjeg>)
- 14]. Topalli, K. (2009). *Nyjat e shqipes. /Članovi u albanskom jeziku*. Tiranë : Toena.
- 15]. Vokri, M. (2017). *Sistemi rasor i shqipes në këndvështrimin historik*, Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, Prishtinë-Tiranë

<sup>446</sup> Banfi hypothesizes the direction Gen > Dat in opposition to Manzini & Savoia’s theory of case percolation Dat > Gen (cf. 2.).

<sup>447</sup> Sh. Për këtë IL H , 2019v., Coteanu, Morf. Numelui, 53 v., 59; për numrin shumës sh. Edhe Skok, *Considerations*, 164.

<sup>448</sup> Sh. Sandfeld, vep. Sit., 186; Ekzistenca e një gjinore-dhanoreje, pra , është një fakt i vërtetuar dhe kjo ndeshet që në shekujt e parë të erës sonë. (Sh. Dieterich, *Untersuchungen*, f. 149 v., ) Por ka këtë ndryshim që në greqishte gjinorja e vjetër është bërë edhe dhanore, kurse në rumanishte dhe në shqipe dhanorja e vjetër është bërë edhe gjinore”.